

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për paketën fiskale dhe buxhetin e vitit 2024.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të interesit dhe ato të marginalizuara të Bashkisë Shijak ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të paketës fiskale dhe projekt buxhetin e vitit 2024.

Sqarime: Konsultimi publik në lidhje me projekt buxhetin e vitit 2024 bazohet mbi të dhënat e raportit të performancës për vitin 2022 si dhe rekomandimet e marra nga pyetësi i zhvilluar on line për tavanet buxhetore 2024-2026.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambientet e **sallës së Këshillit Bashkiak, Xhafzotaj, në datë 16/10/2022, ora 17:00.**

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura deri më datë 15 tetor 2023, në adresat e emaileve:

kozetadoda@yahoo.com fabianakeci@gmail.com

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, drejtues/punonjës të administratës, drejtoria e buxhetit dhe financës, sektori i tatim taksave, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësive Administrative.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Shijak, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit dhe përfaqësues të komunitetit musliman në Shijak, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon konsultimin e paketës fiskale dhe projekt buxhetit të vitit 2024.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i draftit të paketës fiskale dhe projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton taksat dhe tarifatat si dhe fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi draftin të buxhetit të vitit 2024.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, BRENDA DATËS 15 Tetor 2023. kozetadoda@yahoo.com fabianakeci@gmail.com

	Adresa: Këshilli i Bashkisë, Njësia Administrative Xhafzotaj kati 3.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Ndryshime taksat dhe tarifat ne paketën fiskale si dhe në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, ndërfaqja këshilli bashkiak, file - konsultimet publike, projekt buxhetit 2024.
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndër marrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në 15 Tetor 2023 , nëpërmjet adresave të emailit: kozetadoda@yahoo.com fabianakeci@gmail.com Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të paketës fiskale dhe projekt buxhetit vjetor; 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 9. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	22.09.2023